



KDWV-OEGJK

Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Newsletter

July 5th


Icon Tower (Kati 9)
Rr. Bekim Fehmiu 110,
10000 Prishtinë, Kosovë

www.oegjk.org

UPCOMING EVENTS IMPORTANT DATES



July - September	“Women Going Digital”
September 24	“10 Years of the Berlin Process - The Western Balkans as an Economic Area on the Path to the EU”, BMWK Conference Center in Berlin
September 24	Ost-West Forum BAYERN 2024, Regensburg
October 1	SUBEX, Pristina
October 2-3	2nd German-Kosovar Economic Forum, Pristina



Newsletter
July 5th

Director's Note

Të nderuar
anëtarë të Odës Ekonomike
Gjermano-Kosovare,

Në këtë edicion të Newsletter, ju sjellim përmbledhjen më të fundit të lajmeve të aktiviteteve tona si dhe partnerëve; nga delegacioni bavarez në Prishtinë, ngjarja rrjetëzuese “Business After Hours”, organizimet e përbashkëta me Ambasaden gjermane në Prishtinë dhe kompanië, thirrja e hapur nga WB6 CIF për kompanitë e mesme dhe të vogla, akreditimi i Melita & Partners për kualifikimin Nëpunës Kontabiliteti, Niveli IV, panairi “IDE dhe INOVACION”, e deri tek lansimi i projektit “Marigona Sun”.

Ju falenderojmë që jeni pjesë e komunitetit tonë!

Dear
members of the German-Kosovar
Business Association,

In this edition of our Newsletter, we bring to you the latest summary of news from our activities and our partners; from the Bavarian delegation in Pristina, the networking event “Business After Hours”, joint public viewings with the German Embassy in Pristina and member companies, the open call for small and medium companies from WB6 CIF, the accreditation of Melita & Partners for the Level IV Accounting Officer qualification, the “IDEA and INNOVATION” fair, and the launch of the “Marigona Sun” project.

We thank you for being part of our community!

Delegacioni i lartë gjerman nga Parlamenti Bavarez vizitoi Kosovën tek OEGJK dhe kompania anëtare, Celonis

Delegacioni i lartë gjerman nga Parlamenti i Bavarisë nisi vizitën e tyre në Kosovë me një mikpritje të ngrohtë në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), në bashkëpunim me Ambasadën Gjermane në Prishtinë. Nën drejtimin e Karl Freller, delegacioni i deputetëve nga CSU u mirëprit nga Nora Hasani, Drejtoreshë Ekzekutive e KDWW-së, së bashku me Zëvendës Ambasadorin Matthias Conrad.

Gjatë vizitës së tyre, delegacioni u informua për zhvillimet ekonomike në Kosovë që nga paslufta, me një theks të veçantë në rritjen e qëndrueshme të investimeve të huaja, sidomos nga Gjermania, l cili është investitori më i madh në Kosovë. Diskutimet përfshinin tema ekonomike, çështje politike aktuale, sigurinë kombëtare dhe mundësitë për zhvillim dhe bashkëpunim të mëtutjeshëm, jo vetëm brenda Kosovës por edhe në rajon.

Një interes i veçantë për delegacionin ishte sektori i energjisë në Kosovë, ku ata u njoftuan për Strategjinë e Energjisë 2030, zhvillimet e fundit në sektor, dhe potencialin për tërheqjen e investimeve të huaja, në veçanti në energjinë diellore dhe erë. Pikat kyçe të takimit përfshinin Procesin e Berlinit dhe perspektivën evropiane të Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, reformat në sektorin e energjisë, arsimin dhe zhvillimin profesional.

Pas diskutimeve në OEGJK, delegacioni gjerman vazhdoi vizitën në Celonis, një kompani decacorn gjermane me bazë në Mynih që ka investuar në Kosovë.

Sipas motos së OEGJK, ambasadorët më të mirë të Kosovës janë ndërmarrësit dhe kompanitë anëtare të saj. Gjatë një dreke pune, kompanitë anëtare si Baki Automobile (Partner i Volkswagen në Kosovë), LIDL (Tregti), Concentrix Balkans (BPO), MUNDA Kosovo (Automotive) dhe Numarics AG (FinTech) ndanë historitë e tyre të suksesit të investimeve në Kosovë me delegacionin e CSU.



The delegation from the Bavarian Parliament visited Kosovo at KDWW and its member company, Celonis

The high-level German delegation from the Bavarian Parliament started their visit to Kosovo with a warm reception at the German-Kosovar Business Association (KDWW), in collaboration with the German Embassy in Pristina. Led by Karl Freller, the delegation of CSU parliamentarians was greeted by Nora Hasani, Executive Director of KDWW, alongside Deputy Ambassador Matthias Conrad.

During their visit, the delegation was briefed on Kosovo's economic developments since the post-war era, with a particular emphasis on the sustainable increase in foreign investments, notably from Germany—the largest and continuing major investor in Kosovo. Discussions ranged from economic topics to current political issues, national security, and opportunities for further development and cooperation, not only within Kosovo but also across the region.

Of particular interest to the delegation was Kosovo's energy sector, where they were informed about the Energy Strategy 2030, recent sector developments, and the potential for attracting foreign investments, particularly in solar and wind energy. Key points of the meeting ranged from the Berlin Process and Kosovo's European perspective for EU accession to reforms in the energy sector, education, and professional development.

Following their discussions, the German delegation continued their visit to Celonis, a German decacorn company based in Munich that has invested in Kosovo.

According to KDWW's motto, Kosovo's best ambassadors are its entrepreneurs and member companies. At a working lunch, member companies like Baki Automobile (Volkswagen Partner in Kosovo), LIDL (Retail), Concentrix Balkans (BPO), MUNDA Kosovo (Automotive), and Numarics AG (FinTech) shared their success stories of investing in Kosovo with the CSU delegation.



Me datë 3 Korrik u mbajt ngjarja rrjetëzuese, Business After Hours

OEGJK është e lumtur që ky event, i kthyer tashmë në traditë, u ofron anetareve mundësi për rrjetëzim dhe bashkëpunime të reja.

Eventi u sponsorizua nga kompania jonë anëtare Vidasus Distillery dhe u mbajt në ambientin e bukur të Dashni & Brina.

Vidasus Distillery prodhon pije alkoolike artizanale si gin, vodka dhe likere të ndryshme duke përdorur erëza dhe fruta vendore, me synimin për të promovuar kulturën dhe ekonominë lokale.

Produktet e tyre kombinojnë metodat tradicionale me teknikat moderne, duke reflektuar trashëgiminë shqiptare në markën dhe recetat e tyre.

On July 3rd, the networking event, Business After Hours, was held

KDWW is pleased that this event, now a tradition, offers members opportunities for networking and new collaborations.

The event was sponsored by our member company Vidasus Distillery and held in the beautiful setting of Dashni & Brina.

Vidasus Distillery produces artisanal alcoholic beverages such as gin, vodka, and various liqueurs using local herbs and fruits, aiming to promote local culture and the economy.

Their products blend traditional methods with modern techniques, reflecting Albanian heritage in their branding and recipes.



Bashkohuni me OEGJK për ndeshjet e Gjermanisë në UEFA EURO 2024!

Në vazhden e ndeshjeve emocionuese të futbollit, OEGJK dhe Ambasada gjermane në Prishtinë po organizojnë public viewings, për të mbështetur Gjermaninë drejt titullit kampion në UEFA Euro 2024.

Një falenderim i veçantë për anëtarin e bordit të OEGJK, Drinor Selmanaj, nga Sentry - Cybersecurity & Defense, për sponsorizimin e kësaj ngjarjeje me datë 29 Qershor.

Ju ftojme të bashkangjiteni edhe sonte, **me 05.07, nga ora 18:00 në Beergarden Pub** për të mbështetur Gjermaninë në ndeshjen e çerekfinales kundër Spanjës. Kësaj radhe, falenderojmë kompaninë anëtare, Baki Automobile, për sponsorizimin e kësaj mbrëmjeje.



Join KD WV for Germany's matches in UEFA EURO 2024!

In the wake of thrilling football matches, KD WV and the German Embassy in Pristina are organizing public viewings to support Germany on their path to the UEFA Euro 2024 finals.

A special thanks to KD WV board member, Drinor Selmanaj, from Sentry - Cybersecurity & Defense for sponsoring the event on June 29th.

We invite you to join us again tonight, **July 5th, from 6:00 PM at the Beergarden Pub** to support Germany in the quarter-final match against Spain. This time, we thank our member company, Baki Automobile, for sponsoring the eventin.



Mundësi për kompanitë e mesme dhe të vogla të Ballkanit Perëndimor

WB6 CIF fton kompanitë e vogla dhe mesme nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB6) të marrin pjesë në programin për ndihmë teknike, i cili synon hyrjen në tregjet e BE-së, me një fokus të veçantë në Gjermani dhe Itali.

Kompanitë e përzgjedhura do të marrin mbështetje falas për vendosjen e produkteve të tyre në këto tregje, duke përfshirë mundësi rrjetëzimi në evente në Berlin dhe Bologna, analiza të specializuara të tregut, trajnime të personalizuara, dhe njohuri për përdorimin e mjeteve digjitale për analizën e eksportit.

Kompanitë e kualifikuara duhet të jenë të regjistruara në shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe të demonstrojnë gatishmëri për eksport. Aplikimet janë të hapura deri më **12 korrik 2024**.

Melita & Partners akreditohet për kualifikimin: Nëpunës Kontabiliteti, Niveli IV

Melita & Partners, kompania anëtare e OEGJK, është akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për kualifikimin Nëpunës Kontabiliteti, Niveli IV.

Kjo arritje nënvizon përkushtimin e tyre për të ofruar trajnim dhe certifikim të cilësisë së lartë, duke përmbushur standardet e vendosura nga organi qeverisës.

Kualifikimi i Nëpunësit të Kontabilitetit, Niveli IV, përfshin module trajnime gjithëpërfshirëse që mbulojnë aftësitë thelbësore të menaxhimit financiar, ku pjesëmarrësit mund të mësojnë të navigojnë në kompleksitetet e praktikave të kontabilitetit modern.

Opportunity for small and medium-sized companies from the Western Balkans

WB6 CIF invites small and medium-sized companies (SMEs) from the Western Balkans Six (WB6) region to participate in a Technical Assistance program aimed at entering the EU markets, specifically focusing on Germany and Italy.

Selected companies will receive free support to place their products in these markets, including networking opportunities at events in Berlin and Bologna, tailored market insights, specialized trainings, and digital tools mastery for export analysis.

Eligible companies must be registered in WB6 countries and demonstrate readiness to export. Applications are open until **July 12th, 2024**.

Melita & Partners is accredited for the Level IV Accounting Officer qualification

Melita & Partners, KDWW's member company, has been accredited by the National Qualifications Authority for the Level IV Accounting Officer qualification.

This significant milestone highlights the firm's commitment to delivering high-quality training and certification, meeting the stringent standards set by the governing body.

The Level IV Accounting Officer qualification encompasses comprehensive training modules that cover essential financial management skills, where participants can learn to navigate the complexities of modern accounting practices.

Mundësi të jeni pjesë e Panairit “IDE dhe INOVACION”

Nga data 19 deri më 21 shtator 2024, do të mbahet Panairi IDE dhe INOVACION në Prishtina Mall, me pjesëmarrje nga entitete lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Me një hapësirë prej mbi 4,000 m², ky panair premton shkëmbime idesh, produktesh dhe shërbimesh mes Kosovës dhe tregjeve të jashtme.

Nëse jeni të interesuar të eksploronit teknologjitë më të fundit ose të zbuloni zgjidhje inovative, mos e humbni mundësinë për të marrë pjesë si ekspozues.

Për më shumë informacione na shkruani në info@oegjk.org

Opportunity to be a part of the “IDEA and INNOVATION” Fair

From September 19 to 21, 2024, the “IDEA and INNOVATION” Fair will be held at Prishtina Mall, featuring participation from local, regional, and international entities. With an area of over 4,000 m², this fair promises an exchange of ideas, products, and services between Kosovo and international markets.

If you are interested in exploring the latest technologies or discovering innovative solutions, don't miss the opportunity to participate as an exhibitor.

For more information contact us at: info@oegjk.org

Lansimi i Projektit “Marigona Sun”

Më 20 Qershor, kompania anëtare e OEGJK, Marigona Inc., lansoi projektin Marigona Sun. Ky projekt, i cili ndodhet pranë lagjes Marigona Hill dhe mbulon një sipërfaqe prej 13.4 hektarësh, prezantoi 157 shtëpi të dizajnuara me kujdes, duke kombinuar stilin modern me komfortin praktik.

Fokusi i projektit Marigona Sun është krijimi i një mjedisi miqësor për komunitetin, duke ofruar rrugë private, zona gjelbëruese dhe shërbime si një qendër biznesi e vogël. Duke qenë e vendosur për të ndryshuar standardet rezidenciale në Prishtinë, Marigona Sun premton një stil jetese të ekskluzivitetit, qetësisë dhe jetesës urbane moderne për banorët. Projekti synon të bëhet një pikë referimi në qytet, duke ofruar një standard të ri të jetesës luksoze dhe cilësisë.

The Launch of the “Marigona Sun” Project

On June 20th, KDWW's member company, Marigona Inc., launched the Marigona Sun project. Situated near the Marigona Hill neighborhood and covering an area of 13.4 hectares, this project introduces 157 carefully designed homes that blend modern style with practical comfort.

The focus of the Marigona Sun project is to create a community-friendly environment, offering private roads, green areas, and amenities such as a small business center. Positioned to redefine residential standards in Pristina, Marigona Sun promises an exclusive lifestyle characterized by tranquility and modern urban living for its residents. The project aims to become a landmark in the city, setting a new standard for luxurious living and quality of life.

**OUR
CONTACT PERSON
AT KDWW**

**Monday / Friday
08:30 - 16:30**

**BOOK
YOUR APPOINTMENT AT
KDWW-OEGJK**

Icon Tower (Kati 9)
Rr. Bekim Fehmiu 110,
10000 Prishtinë, Kosovë



Koordinatore

Coordinator

**Department
for Advocacy and
Government Relations**

Rreze Gashi

rreze.gashi@oegjk.org



KDWV-OEGJK

Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Icon Tower (Kati 9)
Rr. Bekim Fehmiu 110,
10000 Prishtinë, Kosovë

www.oegjk.org